



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 589/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur ankesë kundër Kryesuesit të vendvotimit Bekim Berisha për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje

ARSYETIM

Subjektit Politik LVV dega në Prishtinë ka parashtruar ankesë kundër kryesuesit të VV, duke pretenduar se më datë 12.12.2010 në VV1909e/09D në shkollën fillore “Hasan Prishtina” në Prishtinë, vëzhguesit e LVV Venhar Sadiku nuk iu është lejuar t’i paraqesë vërejtjet e tij në Librin e Votimit nga ana e kryesuesit të këtij VV Bekim Berisha. Sipas parashtruesit të ankesës kryesuesi i këtij VV Bekim Berisha, ka vepruar në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore nr. 09/2009 neni 4.2.

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga LVV, duke pretenduar se kryesuesi i VV 1909e/09D ka shkaktuar parregullsi gjatë procesit të votimit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e subjektit politik LVV, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

. PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 589/2010 më datën 16.12.2010.

